



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

IPKO TELECOMMUNICATION L.L.C

Robert Erzin
Drejtor Ekzekutiv
Prishtinë

Ankesa Nr. 2012/187 KPM v IPKO
Ref: 1301/009/KPM/nr

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2012/187 Komisioni i Pavarur për Media (KPM) kundër Ipko Telecommunication L.L.C. ("Pala Përgjegjëse")

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM) me datën 6 korrik 2007, ka miratuar Rregulloren për Distribimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC-2007/04, për rregullimin e Operatorëve Kabllor dhe Ofruesve të Shërbimeve Programore që veprojnë në territorin e Republikës së Kosovës.
2. Pala Përgjegjëse, me datë 8 gusht 2008, është pajisur me licencë të KPM-së. Me marrjen e Licencës Pala Përgjegjëse është obliguar që të respektojë Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termat e Përgjithshme të Licencës si dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM.
3. KPM-ja me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Ligjin e KPM-së, me datën 8 nëntor 2012, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse dhe ka gjetur se ky operator në mënyrë të vazhdueshme është duke vepruar në kundërshtim me Ligjin e KPM-së, pasi që në platformën e vetë kabllore bartë kanalet Super Sport 1 Kosova, Super Sport 2 Kosova, Super Sport 3 Kosova, Super Sport 1 Kosova HD, Super Sport 2 Kosova HD, Super Sport 3 Kosova HD të cilat nuk janë të licencuara në KPM.
4. KPM me qëllim të sqarimit të kësaj çështje me datën 23 gusht 2012, nëpërmjet postës elektronike ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse dëshmi për licencimin këtyre kanaleve qoftë edhe nga ndonjë shtet tjetër. Pala Përgjegjëse me datë 28 gusht 2012, është përgjigjur ndaj kërkesës së KPM-së, duke potencuar se kanalet Super Sport Kosova nuk janë të licencuara në asnjë shtet tjetër e as në Kosovë, dhe ato bartën në platformën kabllore të IPKO-s, si kanale të palicencuara.
5. KPM-ja gjithashtu me datën 29 gusht 2012, përsëri nëpërmjet postës elektronike e ka njoftuar Palën Përgjegjëse se bartja e kanaleve të palicencuara përbën shkelje të rend të Ligjit të KPM-së dhe se vazhdimi i bartjes se kanaleve të palicencuara mund të rezultojë me masën sanksionuese deri në shumën prej 100,000.00 euro.
6. KPM-ja bazuar në shkeljen e nenit 21, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 14 nëntor 2012, i ka dërguar Njoftim për Shkelje nëpërmjet të cilit është udhëzuar që menjëherë të ndalon bartjen e kanaleve të shpërmendura deri në licencimin e tyre,

Rruga Gazmend Zajmi #1, Prishtina - Gazmend Zajmi Street #1, Pristina - Ulica Gazmend Zajmi #1, Priština

t. +381 (0)38 245 031 f. +381 (0)38 245 034 e. info@imc-ko.org

në të kundërtën KPM-ja do të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse për shkeljet e bëra.

7. KPM-ja serish me datën 21 nëntor 2012, ka bërë monitorimin e Palë Përgjegjëse ku ka gjetur se edhe përkundër Njoftimit për Shkelje Pala Përgjegjëse ka vazhduar të veproj në kundërshtim me nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së.
8. KPM-ja duke u bazuar në shkeljet e vazhdueshme të nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së, me datën 26 nëntor 2012, i ka dërguar Palës Përgjegjëse Vërejtje përmes së cilës i është bërë me dije së bartja e mëtutjeshme e kanaleve të pa licencuara do të rezultojë me masa sanksionuese kundër Palës Përgjegjëse në bazë të nenit 30 të Ligjit të KPM-së.
9. KPM edhe pas Vërejtjes se dërguar ka vazhduar me monitorimin e Palës Përgjegjëse ku me datën 27 nëntor 2012, ka gjetur se Pala Përgjegjëse në mënyrë të vazhdueshme ka bartur kanalet e pa licencuar përmes platformës së vete kabllore, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së.
10. Pala Përgjegjëse me datën 27 nëntor 2012, është përgjigjur ndaj vërejtjes së KPM-së, duke pranuar së ka bërë lëshim në drejtim të respektimit të Ligjit të KPM-së.

Analiza Ligjore

11. Komisioni bazuar në faktet e shpërmendura konkludon se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së, si dhe në kundërshtim me nenin 11 paragrafi 2 dhe 3 si dhe nenin 16 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores për Distribim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC 2007/04.

Neni 21 paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton:

“Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”

Neni 11 paragrafi 2 i Rregullores CIMC 2007/04 përcakton:

“Çdo operator kabllor ka përgjegjësi për të garantuar se përmbajtja e të gjitha shërbimeve të programit të shpërndara përmes sistemit kabllor është në përputhje me Ligjin për KPM-në dhe rregulloret, si dhe me kërkesa tjera ligjore”.

Neni 11 paragrafi 3 i Rregullores CIMC 2007/04 përcakton:

“Nëse një operator kabllor gjen se një shërbim i programit ka përmbajtje ilegale, edhe pse ai ka ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme të kujdesit, operatori kabllor duhet ta ndërpresë menjëherë shpërndarjen e mëtutjeshme të përmbajtjes ilegale dhe të ndërmarrë masa që të sigurohet se një gjë e këtillë nuk do të përsëritet”

Neni 16 paragrafi 1 i Rregullores CIMC 2007/04 përcakton:

“Operatori kabllor i cili prodhon dhe ofron program të vetin duhet të jetë i regjistruar për shërbime të transmetimit”.

Neni 16 paragrafi 2 i Rregullores CIMC 2007/04 përcakton:

“Ofruesi i shërbimeve kabllore i cili prodhon programin e tij të radios ose televizionit do të ketë statusin e Stacionit Televiziv Kabllor kur shpërndan programin e vet nëpërmes sistemit kabllor”

12. KPM-ja duke u bazuar në raportet e monitorimit gjen se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapa të nevojshme për të vepruar në pajtueshmëri me nenin 21, paragrafin 1, të Ligjit të KPM-së dhe nenin 11.2, 11.3, si dhe nenin 16.1 dhe 16.2 të Rregullores për Distribuum Kabllorë të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC-2007/04, pasi që në mënyrë të vazhdueshme bartë kanalet e pa licencuara përmes platformës së vete kabllore.
13. Bartja e kanaleve të pa licencuara nga ana e Palës Përgjegjëse konsiderohet shkelje e rend e Ligjit të KPM-së, duke pas parasysh së për të ushtruara transmetim në Kosovë kërkohet licencë të cilën e lëshon KPM-ja.
14. Pala Përgjegjëse nëpërmjet kanaleve të Super-Sport Kosova në mënyrë të vazhdueshme transmeton ndeshje të futbollit, ky transmetim ndikon direkt në tregun medial duke transmetuar nëpërmjet këtyre kanaleve katër liga të futbollit, Ligen Angleze, Ligen Gjermane, Ligen Italiane, Ligen e Kampionëve si dhe disa ndeshje të ligave të futbollit vendor. Gjithashtu, përmes këtyre kanaleve pala përgjegjëse ka ritransmetuar edhe ndeshjet e Ligës Spanjolle pa të drejtë për ri-transmetim. Transmetimi i përmbajtjeve programore nëpërmjet kanale të pa licencuara konsiderohet transmetim ilegal.
15. Pala Përgjegjëse ka dështuar të veprojë në pajtim me nenin 21, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së duke bartur kanalet e Super-Sport Kosova nëpërmjet platformës së vetë kabllore edhe përkundër faktit së këto kanale asnjëherë nuk janë licencuar në KPM.
16. KPM-ja me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Ligjin për KPM-në, në mënyrë të vazhdueshme ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse dhe ka konstatuar se Pala Përgjegjëse në mënyrë të vazhdueshme bartë përmes platformës së vete kabllore kanale të cilat nuk janë të licencuara në KPM.
17. Bazuar në raportet e monitorimit është gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër njoftimeve përmes postës elektronike të datës 23 dhe 29 gusht, Njoftimit për Shkelje dhe Vërejtjes ka vazhduar të veproj në kundërshtim me nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së dhe nenin 11.2, 11.3, si dhe nenin 16.1 dhe 16.2 të Rregullores CIMC-2007/04.
18. KPM ka vazhduar me monitorim e Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të respektimit të këtij neni, prandaj Komisioni si rrethanë rënduese për Palën Përgjegjëse ka marrë për bazë shkeljet e vazhdueshme edhe pas kërkesave të KPM-së për të vepruar në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së si dhe vendimet e me hershme sanksionuese të natyrës së njëjtë, ato të datës 1 shtator 2008 dhe atë të datës 27 mars 2009.
19. Komisioni duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konkludon se, Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të vazhdueshme të nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së si dhe nenit 11 paragrafi 2 dhe 3 dhe nenin 16 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores për Distribuum Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC 2007/04.

Vendim

20. Bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e shpërmendura, Komisioni gjen se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së, nenit 11 paragrafi 2 dhe 3 dhe nenin 16 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores për Distribuum Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC 2007/04.
21. Komisioni konstaton se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 21, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së si dhe në kundërshtim me nenin 11 paragrafi 2 dhe 3 dhe nenin 16, paragrafi 1 dhe 2, të Rregullores CIMC 2007/04, pasi që në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet platformës kabllore bartë gjashtë kanale të pa licencuara.

22. Komisioni bazuar në nenin 30 pika 1.3 të Ligjit të KPM-së, vendos që Palës Përgjegjëse t'i shqiptoj dënim me gjobë në shumë prej 60,000.00 (gjashtëdhjetë) mijë euro për shkeljen e nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së dhe shkeljen e nenit 11 paragrafi 2 dhe 3 dhe nenin 16 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores CIMC 2007/04. Pala Përgjegjëse gjithashtu obligohet që të bëjë ndërprerjen e menjëhershme të bartjes së kanaleve të palicencuara në mënyrë që të veprojë në pajtim me Ligjin e KPM-së dhe Rregulloren CIMC 2007/04.
23. Në rast se Pala Përgjegjëse edhe pas pranimit të këtij vendimi vazhdon të veprojë në kundërshtim me Ligjin e KPM-së dhe Rregulloren CIMC-2007/04 apo aktet tjera nënligjore të KPM-së, Komisioni do të ndërmarrë masa tjera sanksionuese ndaj Palës Përgjegjëse në pajtueshmëri me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.
24. Ky vendim bëhet i plotfuqishëm në momentin e pranimit nga ana e Palës Përgjegjëse. Ankesa kundër këtij vendimi nuk e ndalon ekzekutimin e tij, sipas nenit 30 paragrafi 2 pika 2 të Ligjit të KPM-së.

E drejta për Ankesë

25. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42 paragrafi 2 të ligjit të KPM-së.
26. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.
27. Bordi për Ankesa mundet pa dëgjim të hedh poshtë ankesat të cilat nuk janë të bazuara në njëri nga këto dy mundësi, apo të cilat, nën dispozitat e vendosura nga Bordi për Ankesa në pajtueshmëri me paragrafin 2. të nenit 42 të këtij ligji janë të papranueshme sepse janë të pavlera keqdashëse apo të pabaza.

Lëshimi i Vendimit

Komisioni e lëshon këtë vendim

Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media



28.12.2012
datë